

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 18 10 2024		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 307	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor i Komitetit për Politikë dhe Financa bashkë me kryesuesin për hartimin e buxhetit për vitin 2025

Me datën 9.09.2024 është mbajtur dëgjimi publik i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe kryesuesi i Kuvendit Xahvit Zariqi.

Në këtë dëgjim buxhetor ka marrë pjesë, Xhavit Zariqi kryesues, Sebahate Ajeti-Sadiku, Mimoza Sojeva- Pajaziti, Hatixhe Bungu, Lulzim Abazi, Brahim Osmani si dhe Shyhrete Topalli udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun.

Fillimisht kryesuesi i kuvendit Xhavit Zariqi, ka përshëndetur të pranishmit dhe i falënderoi të gjithë qytetarët pranishëm për kontributin e dhënë me kërkesat e tyre për realizimin të projekteve nga ana e Komunës për vitin 2025.

E nga ana tjetër drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, të pranishmit i ka njoftuar në lidhje me buxhetin e vitit 2025, por edhe me kërkesat e qytetarëve që i kanë parashtruar gjatë dëgjimeve buxhetore që ka mbajtur ekzekutivi komunal.

Pas fjalës hyrëse fjala ju kalua të pranishmëve në sallë.

Sadri Aliu

- Kur pritet të funksionalizimet kopshti në fshatin Talinocv?
- Çka po ndodh me tregun e kafshëve dhe qendrën për trajtimin e qenve?
- Kur pritet të funksionalizimet stacioni i ri i autobusëve?
- A planifikohet të bëhet trafiku urban?
- A keni mundësi që rruga "Driton Islami" të vendosen drunjë dekorativ?



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ibrahim Hyseni

- A keni parapa në buxhetin e vitit 2025 mirëmbajtjen e projekteve që po realizohen?

Gresa Kllokoqi

- A keni parapa ndarjen e mjeteve edhe për strehimoren që është në qytetin e Ferizajt për mbrojtjen e grave?

Rexhep Ademi

- Nënkalimi në fshatin Greme nuk është duke funksionuar, a ka mundësi që tek ajo pjesë e fshatit të bëhet një rreth-rrotullim?

Sadat Ismajli

- A mund të bëhet rregullimi i rrugëve të arave në fshatin Komogllave, por edhe në fshatrat tjera.

Të gjitha këto kërkesa, kanë marrë përgjigjet e duhura nga ana e zyrtarëve komunal.

Ky dëgjim buxhetor ka përfunduar në orën 11:00.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli